



# Business Newsletter

Gusht, Numri 4

Kompanitë kombëtare, prodhuesit dhe eksportuesit të kontribuojnë në prosperitetin e Shqipërisë përmes rritjes dhe performancës konkurruese në tregjet e brendshme dhe globale.

# 2017



## Në brendësi

- Albanian Food Industry (AFI) përshëndet zgjedhjen e Z. Niko Peleshi si ministër i ri i bujqësisë
- Inspektimi i Përgjithshëm, AFI paraqet propozimet
- Arben Ndreka: AFI një instrument i fuqishëm në mbështetje të bizneseve
- Prioritetet e Komitetit të Industrisë së Qumështit për 6 muajt e ardhshëm
- Takimi/Eksporti i produkteve shqiptare drejt Ukrainës

## Albanian Food Industry (AFI) përshëndet zgjedhjen e Z. Niko Peleshi si ministër i ri i bujqësisë



AFI dhe Qendra e Eksporteve Shqiptare, përshëndesin zgjedhjen e Z. Niko Peleshi si ministër i ri i Bujqësisë.

Përzgjedhja nga Kryeministri Edi Rama i Z. Peleshi, është një veprim i duhur i cili do të shërbejë si një nxitës i mëtejshëm për reformat në bujqësinë shqiptare.

AFI dhe Qendra e Eksporteve Shqiptare i urojnë Z. Peleshi suksese në këtë detyrë të re!

Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, e të japim kontributin duke përfshirë ekspertizën tonë, në çuarjen përpara të këtij sektori kaq të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.



## Inspektimi i Përgjithshëm, AFI paraqet propozimet

**A**lban Zusi, Drejtor Ekzekutiv i AFI, së bashku me **Znj. Elvira Sevostianenko**, Sekretare e Përgjithshme e Qendrës së Eksporteve Shqiptare, morën pjesë në konsultimin e zhvilluar nga Inspektorati i Përgjithshëm me fokus reformimin e sistemit të inspektimeve.

Në emër të anëtarëve të AFI dhe Qendrës së Eksporteve Shqiptare, Alban Zusi u shpreh se "biznesi ka qenë tejet entuziast kur u ndërmorën disa nisma dhe u miratua ligji aktual, por zbatimi në tërësi, në këto vite lë shumë për të dëshiruar.

Duke u ndalur në draft-ligjin "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Alban Zusi bëri disa propozime konkrete për të parandaluar përdorimin e inspektimit si 'hanxhar' e mjet presioni.

Sipas Alban Zusit, duhet të përcaktohet në ligj detyrimi i inspektorateve që të bëjnë vlerësimin e riskut për fushën e vet të veprimtarisë dhe më tej edhe ta publikojnë atë.

Gjithashtu duhet të përcaktohet në ligj detyrimi i inspektorateve publikuar raport çdo 6 muaj (na duket pak të përcaktohet vjetor) për arritjet e punës së tyre.

Në të njëjtën kohë, duhet të përcaktohet në ligj detyrimi që secili Inspektorat, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të subjekteve.

Inspektorati i Përgjithshëm i mirëpriti propozimet, duke i publikuar ato në faqen e tyre zyrtare.



**Ne vleresojmë opinionin tuaj.**

**Nëse keni problematika, mendime apo projekte ju lutem na kontaktoni në web**  
<http://afi.albania-export.com>

**dhe Facebook**  
[www.facebook.com/PlatformABU/](http://www.facebook.com/PlatformABU/)

**platforma**  
e BUJQËSISË dhe USHQIMIT



## Arben Ndreka: AFI një instrument i fuqishëm në mbështetje të bizneseve

Arben Ndreka president i kompanisë Lufra, i zgjedhur si kryetar i Komitetit të Industrisë së Qumështit, thotë se është nder dhe privilegj për të, të drejtojë këtë komitetit.

*“Për mua kjo detyrë është një obligim dhe kontribut në çuarjen përpara të përpjekjeve për një industri qumështi me parametra të larta, në të njëjtën kohë të çojmë përpara sigurinë ushqimore në vend”* shpehet Ndreka.

Ky komitet do të fokusohet gjithashtu në rritjen e standardeve për produktet e qumështit.

Sipas tij, ky organizwm i ri nga AFI do të shërbejë për fuqizimin e shoqatës dhe anëtarëve të saj.

*“Duke unifikuar qëndrimet tona dhe bashkëlidhur tyre ekspertizën më të mirë të ofruar nga ekspertët e AFI do të mundësohet zgjidhja e problematikave që ka industria e qumështit të akumuluar ndër vite”* thotë Z. Ndreka.



Ai thekson se bizneset tashmë e kanë kuptuar rëndësinë e të qenit të organizuar nën ombrellën e AFI, që ofron ekspertizën e duhur për ta çuar më përpara industrinë e qumështit.



## Prioritetet e Komitetit të Industrisë së Qumështit për 6 muajt e ardhshëm



Kryetari i bordit

**ARBEN NDEKA**

President i kompanisë Lufra

### Bordi I Industrisë së Qumështit



**ORHAN MILOTI**

President i kompanisë Albamilk



**NIKOLLA GJONI**

Drejtor i kompanisë Gjiofarma

Pas themelimit, Komiteti i Industrisë së Qumështit, zhvilloi takimin e tij të parë.

Nën drejtimin e kryetarit Arben Ndreka, president i kompanisë Lufra, ky komitet caktoi prioritetet për gjashtë muajt e ardhshëm.

Të gjithë anëtarët e këtij komiteti, vlerësuan si imediate pasjen e një analize fiskale për të krahasuar taksat në Shqipëri me ato të rajonit për industrinë e qumështit.

Gjithashtu, u ra dakord që në bashkëpunim me AFI, ky komitet të hartojë projekt propozime për mbështetje nga donatorët e mundshëm në ndërtimin dhe fuqizimin e rrjetit Fermer-Grumbullues-Fabrikë.

Komiteti i Industrisë së Qumështit, vlerësoi si të nevojshëm hartimin dhe nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi mes AFI-t dhe AKU-së.

Gjatë këtij takimi u nënvizua nevoja e një dialogu të vazhdueshëm me qeverinë në hartimin e një programi kombëtar për cilësinë e qumështit dhe vlerësimin e situatës në terren.

Komiteti i Industrisë së Qumështit do të sugjerojë qeverisë, kriteret për drejtorët rajonalë të AKU-së, pasi gjatë katër viteve të shkuara është vërejtur se këto drejtorë janë drejtuar nga njerëz jo profesionistë.



## Takimi/Eksporti i produkteve shqiptare drejt Ukrainës

Albanian Food Industry dhe Qendra e Eksporteve Shqiptare, vijojnë përpjekjet për të mundësuar eksportin e produkteve shqiptare, drejt tregjeve të Ukrainës.

Për të çuar përpara memorandumet e bashkëpunimit, të nënshkuara në Dhjetor 2016, mes Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Doneskut me Qendrën e Eksporteve Shqiptare, gjatë forumit të biznesit Ukrainë-Shqipëri, në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë u zhvillua një takim i përbashkët.

Në këtë takim morën pjesë Z. Alban Zusi, Drejtor Ekzekutiv i Albanian Food Industry, së bashku me Znj. Elvira Sevostianenko, Sekretare e Përgjithshme e Qendrës së Eksporteve Shqiptare, ku të pranishëm ishin përfaqësues nga ministrinë e Ekonomisë dhe Bujqësisë si dhe autoritetet e AKU-së.

Z. Alban Zusi u shpreh se autoritetet shqiptare duhet të nisnin negociatat me autoritetet ukrainase për njohjen e ndërsjelltë nga të dy vendet të certifikatave veterinarë si dhe ato të standardeve.

Që prej muajt Prill deri më tani ekspertët e AFI-t, kanë dërguar një mori me shkresa ku nxisin autoritetet shqiptare të vihen në lëvizje për njohjen e ndërsjelltë të këtyre certifikatave.

Znj. Elvira Sevostianenko e cilësoi këtë takim si një hap përpara për të mundësuar eksportin e prodhimeve shqiptare të qumështit dhe mishit drejt Ukrainës dhe tregjeve të tjera.



## Dy kompani antarësohen në AFI dhe ALB Export

### “Agrimatco Group”

“Agrimatco Group” u themelua ne vitin 1936 në Palestinë. Sot ofron shërbime dhe materiale bujqësore në mbi 50 shtete. Ka punësuar mbi 1500 punonjës, nga të cilët mbi 650 agronome. Gama e produkteve përfshin pesticidet, plehëruesit kimikë, farat, veglat dhe makineritë bujqësore, teknologjitë bujqësore, ushqim për blektorinë dhe produkte veterinarë, duke bashkëpunuar me prodhuesit më të njohur në mbarë botën.

Në Shqipëri Agrimatco operon që nga viti 2010 përmes shoqërisë Agrimatco Albania Shpk. Agrimatco Albania është lider në ushqimin e bimeve, duke ofruar një paketë të plotë për fermerët. Gjithashtu ofron fara hibride të perimeve, pesticide, biopesticide dhe teknologji të avancuara bujqësore. Të gjitha produktet ofrohen edhe si një paketë shërbimi për prodhues të avancuar, ku përveç inpueteve bujqësore ofron edhe konsulencë agronomike.



Kompania Agrimatco

### “Albamilk” Sh.p.k

Fabrika e përpunimit të qumështit “Albamilk” Sh.p.k, e përfaqësuar nga Z. Orhan Miloti e themeluar që në vitin 1995 në Shkodër, ofron produkte që konsistojnë në djathra të familjes “Pasta filata”.

Ne sajë të teknologjisë dhe eksperiences italiane “Albamilk” Sh.p.k ka mbajtur cilesinë më të mirë në tregun shqiptar dhe është pjesë e të gjithë restoranteve dhe picerive në të gjithë Shqipërinë. Djathrat “Albamilk” janë prodhime shume cilesore, të cilat bëhen me qumësht të freskët dhe pa përzierës kimikë.



Kompania “Albamilk”



### Kontaktet tona:



#### Adresa

Rr. "Gjin Bua Shpata", Pallatet e Aviacionit të Vjetër, Shk. 4, Kati i I,  
Ap.16, Tiranë



+355 67 604 52 40



#### email

center@albania-export.com



#### web

<http://afi.albania-export.com>

<http://afi.albania-export.com>



/ALB.Export

/AlbanianFoodIndustry

/PlatformABU

